



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

A nr. 888/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sali Saliu kandidat për Kryetar, dega në Prishtinë, paraqitur kundër shpalljes së rezultateve të KQZ-së, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

## VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Sali Saliu kandidat për Kryetar, dega në Prishtinë.

## Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 15.11.2013, pretendohet se në Komunën e Prishtinës ka pasur parregullsi të llojeve të ndryshme, në të cilën ankesë parashtruesi thekson se numërimi i votës për zgjedhjen e kryetarit të Prishtinës, është zhvilluar në 218 vend votime në territorin e Komunës ku lexues të rezultatit nën vëzhgim të vëzhguesve të akredituar kanë qenë më shumë se 1300 lexues komisioner nga të cilët asnjë lexues rezultati nuk ka qenë nga radhët e të besuarve të kandidatit Sali Saliu, mirëpo 23 të besuar janë lejuar në vend të numërimit si vëzhgues, ku 17 (shtatëmbëdhjetë) prej tyre janë lejuar të jenë prezent në proces të numërimit, kurse 6 (gjashtë) nga ta nuk janë lejuar nga kryesuesi i vend votimit.

Me tutje theksohet se mbulueshmëria pa asnjë komisioner lexueses vetëm me 17 jo lexues po vëzhgues është shprehja me e qartë e jovaliditetit të rezultatit që i ka komunikuar KQZ-së, po ashtu në ankesë theksohet se rezultati nuk pasqyron vullnetin e shprehur të qytetarëve me votë për rezultatit e raportit të forcave të partive politike në numrin e komisioneve që i kanë pasë në vendvotim e që rezultatet i kanë devijuar në dëm të votës së qytetarëve për kandidatin e lartë përmendur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të Sali Saliut kandidatit për Kryetar, dega në Prishtinë, pretendohet se ka manipulim me vota të rezultatit përfundimtar, parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova më të cilën do të vërtetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 888/2013 më datën 18.11.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.